

## **PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

### **PËR**

### **PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 87, DATË 18.12.2019, “PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 81, pika 1, dhe nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

### **VENDOSI:**

Propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 87, datë 18.12.2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_/2025

PËR

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 87, DATË 18.12.2019, “PËR FATURËN DHE  
SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe nenit 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 87, datë 18.12.2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Në shkronjën b, të nenit 4, togfjalëshi “...në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore...” zëvendësohet me togfjalëshin “...në përputhje me ligjin për tatimin mbi të ardhurat...”.

**Neni 2**

Në pikën 2, të nenit 9, fjalja e dytë ndryshon si më poshtë:

*“Nëse blerësi është individ, i paregjistruar si subjekt për ushtrim aktiviteti tregtar, në faturë shënohet emri i tij i plotë, numri personal i identifikimit ID dhe adresa e saktë ku dërgohen mallrat”.*

**Neni 3**

Në pikën 2, të nenit 17, togfjalëshi “...ditën e dhjetë...” zëvendësohet me togfjalëshin “...ditën e njëmbëdhjetë...”.

#### **Neni 4**

Në fjalinë e parë, të pikës 10, të nenit 20, togfjalëshi “...por jo më vonë se tri ditë nga vendosja e mallrave në këtë regjim...” zëvendësohet me togfjalëshin “...por jo më vonë se dita e shtatë e muajit pasardhës nga vendosja e mallrave në këtë regjim...”.

#### **Neni 5**

Kudo në përmbajtjen e ligjit, togfjalëshi “...tatimit mbi fitimin...” zëvendësohet me togfjalëshin “...tatimit mbi të ardhurat e korporatës...” dhe togfjalëshi “... tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël...” zëvendësohet me togfjalëshin “... tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi...”.

#### **Neni 6**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**NIKO PELESHI**